SHMK GJIMNAZI "KIRIL PEJÇINOVIQ"-TETOVË

Kodeksi i sjelljes së nxënësve

Kodeksi i nxënësve është i përgatitur në bazë të të drejtave dhe të përgjegjësive të tyre në shkollë të mesme, i rregulluar nga Ministria e Arsimit dhe nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit si dhe me statutin e shkollës.

Detyrimet e nxënësve dhe sjellja e tyre në mjedisin shkollor

1. Të kujdesen dhe ta ruajnë pasurinë e shkollës, pasurinë personale të nxënësve dhe të të punësuarve në shkollë;
2. T'i respektojnë rregullat e shkollës dhe ta ruajnë rendin në shkollë, përndryshe do të merren masa pedagogjike përkatëse;
3. Të mos shfrytëzohet telefoni celular gjatë orës mësimore;
4. Ndalohet rreptësisht hyrja e nxënësve të shkollave të tjera gjatë kohës së mësimit;
5. Kujdestaria e nxënësit gjatë orëve mësimore është e detyrueshme dhe është pëcaktuar në bazë të rregullores së punës të shkollës;
6. Uniforma shkollore është e detyrueshme të mbahet, si gjatë kohës së mësimit teorik, ashtu edhe gjatë mësimit praktik,

Nxënësit do t'i shqiptohet masa pedagogjike e **parapërjashtimit**, për shkak të shkeljes së detyrimeve të sipërthëna dhe mospërmbushjes së përgjegjësive, e pikërisht:

- Vjedhje dhe gënjeshtra në shkollë;
- Ardhja në shkollë nën veprimin e alkoolit dhe të drogës;
- Pirja e duhanit në shkollë;
- Shkatërrimi i pasurisë së shkollës dhe i pasurisë së nxënësve të tjerë dhe të të punësuarve në shkollë;
- Nxënësi i cili e dëmton apo e shkatërron qëllimisht, përkatësisht nga pakujdesia inventarin apo pajisjet e tjera të shkollës, kompensimin e dëmeve të shkaktuara do ta bëjë vetë ai apo nxënësi tjetër që e ka nxitur,
- Sjellja e lëndëve dhe e mjeteve me të cilat rrezikohet siguria e nxënësve, përkatësisht e njerëzve si dhe pasuria e shkollës.

Nxënësit do t'i shqiptohet masa pedagogjike e **përjashtimit**, për shkak të shkeljes së detyrimeve të sipërthëna dhe mospërmbushjes së përgjegjësive, e pikërisht:

- Dhuna psikike, fizike dhe gjinore;
- Shprehja e dhunshme e mostolerancës ndaj të tjerëve në shkollë;
- Mungesa e paarsyeshme me mbi 25 orë, gjatë vitit mësimor;
- Shkelja e qëllimshme e rregullave mbrojtëse gjatë zhvillimit të mësimit praktik si dhe të praktikës profesionale. Në rast të tillë, nxënësi dhe kujdestari i klasës, brenda 3 ditëve duhet t'i kompensojnë dëmet;

- Shitja e drogës ose sjellja e personave të tjerë me simptoma droge, për shkak të të cilëve rrezikohet jeta e nxënësve të tjerë;
- Falsifikimi dhe zhdukja e evidencës pedagogjike dhe e dokumentacionit (ditari i paraleles, dëftesa, diploma, libreza e nxënësit, fletët e evidentimit dhe dokumentet e tjera zyrtare);
- Kërcënimi me mjete nga të cilat rrezikohet dhe kërcënohet lehtë siguria dhe pasuria e nxënësve apo e njerëzve;
- Shkeljet e rënda dhe të qëllimshme të rendit shkollor dhe planifikimi i mëtutjeshëm i tyre (rrahje, dhunë etj.),

Raporti nxënës dhe arsimtar dhe të punësuarve

1. Respektimi i personalitetit të arsimtarit dhe sjellja në përputhje me normat e përgjithshme dhe me rregullat e sjelljes gjatë kohës së mësimit;
2. Përmbushja e rregullt dhe në kohë e detyrimeve të tyre, të përcaktuara me programet mësimore, sipas lëndëve mësimore të caktuara, me kalendarin shkollor dhe me rregullat e tjera.

Raportet ndërmjet nxënësve

Në shkollë dhe jashtë saj, të kujdesen për shëndetin personal dhe të mos e dëmtojnë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve të tjerë si dhe integritetin shpirtëror dhe trupor të të tjerëve.